

# **STATUTI I SHOQËRISË DHE AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Itaka7” Sh.p.k**

Në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, unë, themeluesi i vetëm, sot në datën 07.01.2025:

- Orjon Nallbati**, i biri i Petraqit dhe Tatianës, lindur në datë 02.02.1983, në Korçë dhe banues në Durrës, madhor dhe me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimin me nr. 034403859;

në cilësinë e ortakut themelues krijoj:

**Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “Itaka7” Sh.p.k**, me seli në Rruga “Shyqyri Bërxolli”, Nr. 14, Kati i I, Tiranë, Shqipëri.

Statuti është akti bazë ku do të mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare “Itaka7” sh.p.k, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

## **KREU I NENI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

- 1.1** Ortaku i vetëm i kësaj shoqërie, është:

**Orjon Nallbati**, i cili zotëron 100 % të kapitalit të kësaj shoqërie.

## **NENI 2 EMËRTIMI I SHOQËRISË**

- 2.1.** Shoqëria mban emrin “Itaka7” sh.p.k, dhe është person juridik shqiptar.

**2.2.** Kjo shoqëri e fiton personalitetin e saj juridik, me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**2.3.** Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë akt.

## **NENI 3 SELIA E SHOQËRISË**

**3.1.** Shoqëria “Itaka7” sh.p.k, ka qendrën në adresën Rruga “Shyqyri Bërxolli”, Nr. 14, Kati i I, Tiranë, Shqipëri, dhe ka të drejtë për të hapur degë dhe zyra të përfaqësimit të tjera, në Shqipëri dhe jashtë saj.

**3.2.** Njësitë strukturore, degët dhe përfaqësítë e saj do të ndërtohen konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me atë të vendeve të tjera ku ajo mund të hapë degë.

## **NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

**4.1.** Qëllimi i shoqërisë është: **a)** Kryerjen e shërbimeve të konsulencës në fushën e cybersecurity dhe në mbrojtjen e sigurinë e të dhënavët në përgjithësi dhe ato personale në veçanti; **b)** Kryerjen e kurseve të formimit profesional në cybersecurity dhe në mbrojtjen e

sigurinë e të dhënave; c) Auditimin e subjekteve të ndryshme juridike, të çfarëdolloj forme dhe entiteti, private dhe publike, në mbrojtjen, trajtimin, sigurinë e të dhënave, si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

**4.2.** Shoqëria mund të hapë gjithashtu zyra dhe degë në çdo vend tjeter në botë ku do ta ketë të mundur, apo të përbushë të gjitha levizjet tregtare, industriale, financiare, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të nevojshme, ose që konsiderohen të dobishme për arritjen e qëllimit të saj: mund të kontraktojë kredi dhe financim në përgjithësi, mund të marrë përsipër interesa të tjera, kuota/ aksione, pjesëmarrje në kapitalet e shoqerive të tjera apo dhe kompani të cilat kanë aktivitet tjeter social direkt apo indirekt, pa pasur për qellim vendosjen tek palët e treta.

**4.3.** Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga Ortaku/Ortakët e saj.

**4.4.** Shoqëria mund të zgjerojë ose kufizojë fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

#### **NENI 5 PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE TË SAJ**

**5.1.** Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësisë së ortakëve të saj.

**5.2.** Ortakët e kësaj shoqërie, nuk janë përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, tej kapitalit themeltar të saj, që vetë ata e kanë nënshkruar. Gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakëve të saj.

#### **NENI 6 KOHEZGJATJA**

**6.1.** Shoqëria do të ushtroje aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj.

#### **NENI 7 SIMBOLET E SHOQËRISË**

**7.1.** Shoqëria do të ketë vulën e saj "Itaka7" sh.p.k.

**7.2.** Shoqëria do të ketë faqen e saj të internetit [www.itaka7.com](http://www.itaka7.com).

#### **KREU II NENI 8 KAPITALI I SHOQËRISË**

**8.1.** Kapitali i nënshkruar i shoqërisë "Itaka7" sh.p.k përbëhet nga para me vlerë të barabartë me 1.000 (një mijë) lekë, në përputhje me kontributet e ortakut si më poshtë:

a) Ortaku Themelues **Orjon Nallbati**: Zotëruar i 1 kuote/pjesë me vlerë të përgjithshme 1000 Lek, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

**8.2.** Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**8.3.** Kontributi i ortakut Orjon Nallbati, i cili është nënshkruar, është 1.000 Lekë (një mijë) Lekë, i barabartë me 1 pjesë, sipas pjesëve të përcaktuara në pikën 8.1, e cila përbën 100 % të vlerës së kapitalit.

**8.4.** Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

## **NENI 9** **ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

**9.1.** Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin themeltar ose mund ta zvogelojë atë, por në çdo rast jo nën kufirin e përcaktuar ligjor. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit behet me vendimin e ortaktëve të shoqërisë, me shumicë të thjeshtë, dhe sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**9.3.** Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

**9.4.** Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të ortakëve të shoqërisë, me shumicë të thjeshtë.

**9.5.** Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

## **NENI 10** **TRANSFERIMI I KUOTAVE TEK TË TRETË**

**10.1.** Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen tek të tretët vetëm me miratimin e të gjithë ortakëve nëpërmjet:

- a) shitblerjes.

**10.2.** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim, me shkresë të thjeshtë.

**10.3.** Kuotat mund të trasferohen tek të tretët edhe në bazë të trashëgimisë apo akteve të detyrueshme, si vendimet e gjykatave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**10.4.** Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

## **NENI 11** **TRANSFERIMI I KUOTAVE TEK ORTAKËT** **KLAUZOLA "RUSSIAN ROULETTE"**



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized 'KLAUZOLA' followed by 'RUSSIAN ROULETTE'.

**11.1.** Në rastin kur shoqëria do të ketë më shumë së një ortak, kur njëri prej ortakëve, kërkon të shesë kuotat e veta dhe nuk arrihet dakordësia absolute, pra miratimi i gjithë ortakëve për shitjen e tyre një personi të tretë, do të procedohet në këtë mënyrë, sipas parimeve të të ashtuquajturës "Ruleta Ruse".

**i. Procedura e ofertës**

Në rast se një ortak (në vijim "Ortak Ofertues") dëshiron të shesë kuotat e tij, ai duhet të dërgojë një komunikim me shkrim (edhe nëpërmjet e-mailit) tek ortaku tjetër (në vijim "Ortaku Marrës"), duke specifikuar:

- Dëshirën për të shitur të gjitha kuotat e tij.
- Çmimin për njësi të propozuar për secilën kuotë.

**ii. Opcionet e Ortakut Marrës**

Brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e komunikimit, Ortaku Marrës ka dy opsione:

- Të pranojë ofertën, duke blerë të gjitha kuotat e Ortakut Ofertues me çmimin për njësi të treguar në komunikim, me pagesën që të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi.
- Të refuzojë ofertën, por në këtë rast ai është i detyruar të shesë të gjitha kuotat e tij tek Ortaku Ofertues, me të njëjtin çmim për njësi të treguar në ofertën origjinale.

**iii. Detyrimi për blerje i Ortakut Ofertues**

Nëse Ortaku Marrës refuzon ofertën, Ortaku Ofertues është i detyruar të blejë të gjitha kuotat e Ortakut Marrës me çmimin për njësi të propozuar prej tij. Pagesa duhet të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga përfundimi i afatit për pranimin e ofertës.

**iv. Modalitetet e pagesës dhe transferimit të kuotave**

- Pagesa e çmimit të kuotave do të kryhet përmes transfertës bankare në një llogari të përcaktuar nga ortaku shitës.
- Transferimi i kuotave do të formalizohet brenda 7 (shtatë) ditësh pune nga marrja e pagesës së plotë.
- Shpenzimet që lidhen me transferimin e kuotave do të përballohen nga ortaku blerës.

**v. Moszbatimi**

Në rast të moszbatimit të detyrimit për blerje apo shitje nga ana e ortakut, ortaku tjetër mund të kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm të kësaj klauzole në gjykatën kompetente.

**11.2.** Kjo klauzolë ka përparësi ndaj çdo dispozite tjetër statutore që mund të jetë e papajtueshme me procedurën e përshkruar këtu.

### ORGANI VENDIMMARRËS

**12.1.** Asambleja e kësaj shoqërie është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë. Ortaku do të ketë të drejta vote në përpjestim me përqindjen e kontributit të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqësohet nga Kuota e tij ose pjesë e Kuotës së tij. Ndryshimi i këtij Statuti mund të bëhet vetem me shumicë të cilësuar, pra vetëm me dakordësinë e 75% të kuotave.

**12.2.** Ortaku/ët i/e saj, vendosin me shumicë të thjeshtë, 50% + 1, për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin e shoqërisë etj.

**12.3.** Asambleja e Përgjithshme do të mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër brenda ose jashtë Shqiperise ku Ortakët mund të bien dakord, apo dhe me videokonferenza apo platforma të tjera elektronike. Vendi apo menyra e përzgjedhur, data dhe ora si dhe rendi i ditës dhe dokumentat përkatëse në lidhje me mbledhjen duhet t'i njoftohen Ortakëve me anë të emailit të paktën 3 ditë përpara datës së përcaktuar për maledhjen.

**12.4.** Për çdo vendim të marrë jashtë Shqipërisë një vendim i shkruar duhet t'i dërgohet Administratorit të Shoqërisë. Në rastet kur Asambleja nuk është mbledhur sipas këtij Neni, atëherë Asambleja mund të marrë vendime te vlefshme vetem nese te gjithe Ortaket janë dakord.

**12.5.** Çdo Ortak ka te drejte te perfaqësohet me prokure ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare. Çdo Ortak ka te drejte te marre pjesë ne mbledhje nepermjet mjeteve te komunikimit ne distance sic telekonferencat dhe/ose videokonferencat, etj.

**12.6.** Ortaket pranojne dhe janë dakort per te vendosur duke shprehur voten edhe ne menyre te shkruar nepermjet qarkullimit te dokumentit te shkruar. Draft vendimi se bashku me rendin e dites dhe njoftimin dhe dokumentat mbeshtetese duhet t'i dërgohet Ortakeve me poste, email ose mjete elektronike te sigurta te pakten 5 dite përpara dates se mbledhjes. Ortaket kane te drejte te miratojne vendimin duke derguar një kopje te nenshkuar te projekt-vendimit tek Administratoret ne daten ose përpara dates se mbledhjes. Ortaket te cilet votojne kunder duhet te shprehin kundershtite e tyre per vendimin ne një dokument me shkrim dhe duhet ta dergojne ate tek Administratori. Vendimi do te konsiderohet i miratuar nese kuorumi dhe shumica e kerkuar ne perputhje

me kete Statut jane perm bushur.

**12.7.** Çdo Ortak ka te drejten te votoje ne perputhje me, dhe ne proporcion me vleren nominale te Kuotes se zoteruar prej tij ne kapital.

**12.8.** Vendimet e me poshtme do te merren me nje kuorum pjesemarrjeje prej me shume se  $\frac{1}{2}$  e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:

a. ndryshimi i Statutit.

### **NENI 13 ADMINISTRATORI**

**13.1.** Administratori i shoqërisë "Itaka" sh.p.k. është ortaku: Z. Orjon Nallbati.

**13.2.** Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**13.3.** Administratori i kësaj shoqërie ka të drejtë që, në ushtrim të kompetencave të administratorit, që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme pranë çdo institucioni privat apo publik, si dhe të marrë të gjitha vendimet në interes të shoqërisë.

**13.4.** Administratori i shoqërisë mund të caktohet edhe një person tjeter, jashtë ortakut.

### **NENI 14 KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT**

**14.1.** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara ortakut të shoqërisë.
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përrpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

**14.2.** Administratori është i detyruar të thërrase mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston

rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

**14.3.** Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

**14.4.** Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji i'a jep shprehimi i ortakëve.

**14.5.** Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## NENI 15

### VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

## NENI 16

### BILANCI I SHOQËRISË DHE DIVIDENTET

**16.1.** Brenda 6 muajsh nga mbylli ja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët e shoqërisë miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

**16.2.** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët vendos rreth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

## NENI 17

### MBARIMI I SHOQËRISË

**17.1.** Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
- d) me vendim të gjykatës;

**17.2.** Ortakët e shoqërisë marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të shoqerise emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

**17.3.** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

**17.4.** Nëse ortakët e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 18**

#### **TRANSFORMIMI I SHOQËRISË**

**18.1.** Transformimi i shoqërisë bëhet me vendim të ortakëve të shoqërisë ose kur ekzistojnë faktorë të jashtëm detyrues ligjor. Në këto raste vendimi merret pasi administratori të ketë paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë.

**18.2.** Çdo transformim i bërë në kundërshtim më këtë nen është i pavlefshëm.

#### **NENI 19**

#### **BAZA LIGJORE**

**19.1.** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

**19.2.** Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 20**

#### **MOSMARREVESHJET**

**20.1.** Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

**20.2.** Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

#### **NENI 21**

#### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**21.1.** Ky statut është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të ortakëve të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre në datë 07.01.2025.

**21.2.** Ky Statut u redaktua në gjashtë kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike. Një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**21.3** Për regjistrimin e shoqërisë dhe akteve juridike pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, autorizohet administratori i shoqërisë:

**ORTAKU THEMELUES  
I SHOQËRISË "ITAKA7" SH.P.K.**

**ORJON NALLBATI**

